
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.208 /19	Data: 02.09.2019	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall:

KONKURS

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim

Numri i Referencës : RN00005502

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funksionale: Niveli Profesional

Grada: Niveli i koeficient 7

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Kohëzgjatja e periudhës provuese : 12 muaj.

Qëllimi i vendit të punës: Hartimi, zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit, politikave, dhe dokumenteve tjera për procesin e monitorimit, vlerësimit dhe standardeve si dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve në fushë e vlerësimeve , me mbikëqyrje të kufizuar

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Ndhmon në hartimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, politikave, procedurave dhe dokumenteve lidhur me procesin e monitorimit, vlerësimit dhe standardeve si dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve në fushën e vlerësimeve;
3. Zhvillon dokumente dhe metoda për monitorim dhe vlerësime praktike për krijimin e standardeve për proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies për të gjitha nivelet e shkollimit;
4. Koordinon dhe monitoron punën për zhvillimin e testeve dhe ndihmon në zgjidhjen e dilemave dhe arritjen e konsensusit mes anëtarëve të grupit apo anëtarëve të lëndëve gjatë procesit të zhvillimit të testeve;
5. Administron testet për arsimin parauniversitar dhe siguron trajnimin e drejtorëve të shkollave, inspektorëve dhe mësimdhënësve në përdorimin e testeve lëndore të standardizuara dhe përpunimin dhe interpretimin e arritjeve të nxënësve;
6. Bashkëpunon me institucione ndërkombëtare në fushën e arsimit në mënyrë që praktikat e mira për çështjet e vlerësimit të zbatohen në institucionet arsimore në Kosovë;
7. Mbështet ekipin për zhvillimin e plan programeve në mënyrë që vlerësimi të bëhet pjesë përbërëse e procesit të plan programeve me qëllim të rritjes së efikasitetit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma universitare , Fakulteti I Edukimit, Filologjik dhe Filozofik, minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit
Fatmir Bytyçi